

AKT THEMELIMI

Sot ne dt.30/08/2022 me cilesine e " Ortakeve Themelues ",

ALBAN QËNDRA, emri i babait Asllan, i datelindjes 27/04/1975, i lindur ne Koshtan dhe banues ne Rrugen Butrinti, Ksamil,godine private, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit Ieternjoftimit me Nr.033864599 leshuar nga MPB me date 28/01/2019,

ALEKSANDËR LIKA, emri i babait Qemal, i datelindjes 31/08/1985, i lindur ne Buz dhe banues ne Rrugen 4 Valltaret, Ksamil,godine private, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit Ieternjoftimit me Nr.036612729 leshuar nga MPB me date 11/11/2020,

FATMIR ÇAKO, emri i babait Hekuran, i datelindjes 06/05/1977, i lindur ne Sarande dhe banues ne Lagj.nr.4 Sarande, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit Ieternjoftimit me Nr.036949666 leshuar nga MPB me date 22/02/2021,

KLETON KUBURI, emri i babait Bajram, i datelindjes 06/02/1987, i lindur ne Ksamil dhe banues ne Rrugen 4 Valltaret, Ksamil,godine private, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit Ieternjoftimit me Nr.035502218 leshuar nga MPB me date 10/01/2020,

SOKOL GOLAJ, emri i babait Dalan, i datelindjes 30/07/1969, i lindur ne Sarande dhe banues ne Lagjen nr.4 Sarande,godine private, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit Ieternjoftimit me Nr.034047811 leshuar nga MPB me date 19/03/2019,

te cilet me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKR", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin **BUTRINTI MOLUSK** shpk.

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezqjatia,Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **BUTRINTI MOLUSK** shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar.Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria **BUTRINTI MOLUSK** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **BUTRINTI MOLUSK** shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaket që përballojne humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen:

Lagj 4 Valltaret, Rruga Tafil Buzi, ZK 2297, pasuria nr.3/1274, godine dy kateshe, Ksamil-Sarande

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me Vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

- **Kultivimi i midhjeve ne impjante fikse, grumbullimi, perpunimi dhe tregtia e midhjeve. Import dhe Eksport te mallrave ushqimore dhe industriale.**

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKR.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 6,000,000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 6,000,000 leke i perbere nga 5 kuota dhe zoterohet nga ortaket e shoqerise si me poshte :

1. Ortaku Themelues: **ALBAN QËNDRA**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 1,200,000 Leke, e cila perfaqeson 20 % te kapitalit te shoqerise,
2. Ortaku Themelues: **ALEKSANDËR LIKA**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 3,000,000 Leke, e cila perfaqeson 50 % te kapitalit te shoqerise.
3. Ortaku Themelues: **FATMIR ÇAKO**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 600,000 Leke, e cila perfaqeson 10 % te kapitalit te shoqerise.
4. Ortaku Themelues: **KLETON KUBURI**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 600,000 Leke, e cila perfaqeson 10 % te kapitalit te shoqerise
5. Ortaku Themelues: **SOKOL GOLAJ**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 600,000 Leke, e cila perfaqeson 10 % te kapitalit te shoqerise

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar eshte 6,000,000 Leke e cila do te derdhet ne te ardhmen nga ana e ortakeve te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakët pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Asamblese se ortakeve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.



KREU II
ORGANET VENDIMARRRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimarrës

Asambleja e ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e ortakeve është organi vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e ortakeve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakeve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakeve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: emerimin dhe shkarkimin e administratorëve, të likuiduesve dhe eksperteve kontabel të autorizuar, përcaktimin e shpërblimeve, përfaqesimin e shoqërisë në gjykatë.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR.

Neni 10

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga **z. ALEKSANDËR LIKA**

Emerimi i administratorit është me një afat pesë vjeçar me të drejtë rimerimi, i cili ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet e themelimit të shoqërisë të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblese së ortakeve të shoqërisë.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese së ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.


Administratori ose ortakët që nuk janë persona juridikë nuk u lejohej të kontraktojnë në çfarëdo formë qoftë, të marrin hua të shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.



Neni 13

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per çfaredo shkaku, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar siç mund të jene

- a. Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.
- b. Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"
- c. Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKB, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 15

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare **BUTRINTI MOLUSK** shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

Alban Qendro

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

[Signature]

Klodian Kushi / Fatmir Lako

[Signature]

Sokol Celiku

ALBAN QENDRO *[Signature]*

[Signature]